



Datë: 13.10.2025
Numër Protokolli: 6784/2025

A.nr.1740/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani -kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1740/2025 të datës 26.09.2025, të parashtruar nga ankuesi I.R, „kundër organit të punësimit: Ministria e Kulturës Rinise dhe Sportit, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës* ” duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 13.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës **shpallet jo kompetent** për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës A.nr.1740/2025, të datës 26.09.2025, të parashtruar nga ankuesi I.R.
- II. Pala ankuese udhëzohet mbi të drejtën e inicimit të konfliktit administrativ pranë gjykatës kompetente.

A r s y e t i m

Ankuesi I.R, më datë 26.09.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar nën shenjen A.nr.1740/2025, lidhur me pretendimet ankimore moszbatimi i avancimit në karriere të miratuar dhe nënshkruar nga Menaxhmenti i Ministrisë së Kulturës Rinis dhe Sportit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.1740/2025, të datës 26.09.2025, të parashtruar nga ankuesi I.R, **sepse:**

Nga provat e çështjes, respektivisht nga vërtetimi me numër 4776/2025 i datës 15.09.2025, rrjedhë se ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Kulturës Rinis dhe Sportit nga data 01.09.2004 në pozitën e punës “Vozitës”. Ndërsa me datë 14.04.2023 përmes shkresës zyrtare të zv. Drejtorit të Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme ankuesi ka paraqit kërkesë për avancim në karrierë duke u bazuar në performancën e lartë profesionale, e cila kërkesë është miratuar nga menaxhmenti i lartë i Ministrisë përkatëse.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore përmes vërtetimit të datës 12.09.2025 ka konfirmuar se ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Kulturës Rinis dhe Sportit nga data 01.09.2004, mirëpo nuk ka proceduar me tej për zbatimin e avancimit të ankuesit.

Ankuesi në ankesën e datës 16.09.2025 të parashtruar në Këshillin e Pavarur pretendon se Ministria e Kulturës Rinis dhe Sportit ka shkelur të drejtat e ankuesit duke mos zbatuar vendimin e miratuar për avancim në karriere dhe i njëjti kërkon nga Këshilli që të urdhëroj Ministrinë e Kulturës Rinis dhe Sportit që të bëjë zbatimin e vendimit për avancim.

Në kuptim të përcaktimit të kompetencës së Këshillit në pikëpamje lëndore, pozita të cilën e mbanë ankuesi “Vozitës” nuk bëjnë pjesë në pozitat e shërbimit civil, andaj referuar dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, dhe 1.5, si dhe paragrafi 5 i cili përcakton 1. Kategoritë e zyrtarëve/publik janë: 1.1. Nëpunësja/i i shërbimit civil; 1.2. Nëpunësja/i i shërbimit publik; 1.3. Krijuesja/i dhe performuesja/i e/i artist dhe kulturës; 1.4. Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës; dhe 1.5. Zyrtarja/i i kabinetit si dhe paragrafi 5 ku përcakton se 5. Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës është zyrtarja/i publik që kryen veprimtari ndihmëse të mirëmbajtjes, të ruajtjes, të vozitjes dhe veprimtari të ngjashme në institucionet publike.

Andaj, duke qenë se ankuesi nuk e ka statusin e nëpunësit civil, Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në dispozitat e nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi që të shpallë veten jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.1740/2025 të datës 26.09.2025, të parashtruar nga ankuesi I.R.

Bazuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1740/2025

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit I.R;
- Njesisë për Burime Njerëzore në Ministrinë e Kulturës Rinis dhe Sportit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së;